



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Njoftim për media

Ditën e enjte, më datë 27.11.2014, u zhvillua mbledhja e Këshillit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në prani të anëtarëve të mëposhtëm:

Z. Gentian Sala	Kryetar
Z. Sami Nezaj	Zv/Kryetar
Z. Gledis Gjipali	Anëtar
Z. Piro Misha	Anëtar
Znj. Suela Musta	Anëtar
Z. Zylyftar Bregu	Anëtar

Mbledhja e Këshillit të AMA-s, filloi me prezantimin e Kryetarit të AMA-s, z. Gentian Sala dhe dy anëtarëve të rinj, Gledis Gjepali dhe Pirro Misha. Gjatë fjalës së tij z. Sala, përmendi rëndësinë e zbatimit të ligjit dhe shtimit të transparencës me publikun nga institucioni që ai drejton.

Mbledhja kishte karakter prezantues dhe informues, lidhur me veprimtarinë e institucionit. Cështjet e trajtuara gjatë kësaj mbledhjeje ishin:

1. Prezantimi i veprimtarisë së AMA-s, sipas kompetencës së secilës drejtori.
2. Hapja e procedurës për zgjedhjen e Këshillit të Ankesave të AMA-s.
3. Informacion “Mbi plotësimin e kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit nr. 97/2013”.
4. Informacion “Mbi subjektet radiotelevizive që kanë aplikuar për rinovimin e licencës dhe subjektet që u ka përfunduar afati i licencës”.
5. Informacion “Mbi proceset gjyqësore ku është palë Autoriteti i Mediave Audiovizive”.
6. Relacion “Mbi detyrimet e pashlyera të pagesave për licencë dhe tarifës për shërbimet RTV për vitet 2011- 2014”.
7. Relacion “Mbi projekt-buxhetin për vitin 2015”.
8. Njoftim lidhur me projekt strukturën e AMA-s që do të miratohet në mbledhjen e ardhshme të AMA-s.
9. Prezantimi i problematikës së godinës ku ushtron veprimtarinë e saj AMA.

Po ashtu këshilli i AMA me votim zgjodhi sekretaren e këshillit.

Gjatë mbledhjes pati diskutime dhe u shkëmbyen mendime mbi vënien në eficiencë të institucionit për përballjen e sfidave të kalimit në transmetimet numerike.

Tiranë, më 27 Nëntor 2015